



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHTETËRORE PËR SHKOLLAT E MESME**

LËNDA

**LETËRSI E THELLUAR
(PROVIM ME ZGJEDHJE)**

**KOORDINATORE
ERIDA KOLECI**

VITI MËSIMOR 2014 – 2015

I. HYRJE

Programi orientues për letërsinë e thelluar përfshin njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të kësaj lënde për gjimnazin.

Programi orientues është mbështetur në:

- programet e letërsisë në kurrikulen me zgjedhje të detyruar;
- udhëzuesin kurrikular të gjimnazit;
- standardet e fushës së gjuhës shqipe dhe letërsisë;
- udhëzimin Nr. 1, datë 12.01.2015 të MAS-it për “Zhvillimin e Provimeve të Maturës Shtetërore 2015”.

II. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Programi orientues për provimin e letërsisë së thelluar, në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2014-2015, përbën një dokument të vlefshëm për nxënësit, mësuesit dhe specialistët e përfshirë në procesin e Maturës Shtetërore. Programi, gjithashtu, u vjen në ndihmë inspektorëve të ISHA-s që të monitorojnë planifikimin e mësuesit për sistemimin dhe përforcimin e njohurive të nxënësve.

Ky program orientues:

- siguron informacionin e nevojshëm për mësuesit që do të përgatisin maturantët për provimin e kësaj lënde në Maturën Shtetërore;
- orienton nxënësit për njohuritë dhe aftësitë kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses testin e letërsisë së thelluar;
- përbën, gjithashtu, një dokument zyrtar, që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e testit të letërsisë së thelluar, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Në testin e letërsisë së thelluar do të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Peshat specifike për çdo nivel do të jenë:

- niveli bazë- 40%;
- niveli mesatar- 40%;
- niveli i lartë- 20%.

Në përgatitjen për përbushjen e objektivave të këtij programi do të përdoren teksti mësimor dhe veprat e autorëve mbi të cilët janë ndërtuar modulet në këtë lëndë.

Struktura e testit do të jetë:

Pjesa e parë: tekst letrar (50%)

Pjesa e dytë: tekst letrar (50%)

Dy tekstet letrare në test do t'u takojnë dy gjinive (prozë, poezi ose dramë).

Fragmentet për të dy tekstet do të merren nga veprat e detyruara për t'u lexuar, lista e të cilave ndodhet në fund të këtij programi.

Për përgatitjen për provim, mësuesit dhe nxënësit të kenë parasysh **veprën në tërësi**. Kjo do të thotë që mësuesit duhet t'i aftësojnë nxënësit për të fituar ato aftësi dhe teknika analizuese, të cilat përvetësohen duke pasur parasysh objektivat specifikë të dhënë më poshtë.

III. OBJEKTIVAT SIPAS MODULEVE

Lënda e letërsisë si lëndë me zgjedhje është konceptuar në module të ndërtuara në bazë teme dhe objektivash. Kësisoj, edhe programi orientues do të ketë këtë formë.

MODULI 1: Bota dhe ndryshimi

Tema qendrore: Studimi i heroit, forca e tij në veprën “Skënderbeu” të Sabri Godos

Tematika	Objektivat
Tema e qëndresës	Nxënësi është i aftë:
Gjuha dhe stili	<ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë kontekstin historik, shoqëror, ekonomik dhe letrar;
Interpretimi dhe gjykimi vetjak	<ul style="list-style-type: none">- të reflektojë rrëth lidhjeve të veprës letrare me kontekstin historik, shoqëror dhe ekonomik;- të parashtrojë, të argumentojë dhe të evoluojë idetë e qëndrimet e tij rrëth vlerave të veprës;- të vlerësojë çështje, si p.sh.: tipizimi, kompozicioni, kronologjia e ngjarjeve, rrethanat, mjediset, konflikti, karakteret;- të veçojë tipare të gjuhës së veprës dhe të stilit të autorit;- të analizojë aspektet gjuhësore të veprës;- të analizojë çështjet që lidhen me raportin kulturë-individ-vepër;- të gjykojë rrëth vlerave të veprës, duke iu referuar kritereve, citimeve dhe argumenteve;- të realizojë ese përshkruese dhe argumentuese/ bindëse.

MODULI 2: Bota dhe ndryshimi

Tema qendrore: Studimi i heroit dhe forca e tij në veprën “Jul Çezari” të Shekspirit

Tematika	Objektivat
Heroi dhe karakteri njerëzor	Nxënësi është i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të ilustrojë karakteristikat e dramës dhe stilin shekspirian të saj;
Tipizimi i personazheve	<ul style="list-style-type: none">- të veçojë gjuhën figurative të përdorur, elementet e trillimit në vepër;
Gjuha dhe stili	<ul style="list-style-type: none">- të dallojë forcën e ligjërimit kundërshtues dhe bindës midis palëve;
Veçoritë dramatike dhe tragjike të veprës	<ul style="list-style-type: none">- të parashtrojë idetë e qëndrimet e tij nëpërmjet të shkruarit bindës;- të ilustrojë karakteristikat e personazheve;- të debatojë rrëth ligjërimit bindës dhe veprimit dramatik;- të ilustrojë karakteristikat e veçoritë e veprës;- të debatojë rrëth një teme që lidhet me veprën.

MODULI 3: Bota dhe ndryshimi

Tema qendrore: Rrënjet e formimit të kombit shqiptar (Gjergj Fishta “Lahuta e Malcis”)

Tematika	Objektivat
<p>Aspekti historik Mitologjia dhe figurat mitologjike “Lahuta e Malcis”, kahasuar me vepra të tjera epike</p> <p>Gjuha dhe stili</p> <p>Interpretimi dhe gjykimi vetjak</p>	<p>Nxenësi është i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjë lidhjen midis veprës, historisë kombëtare e më gjerë dhe historisë së shkurtër të krijimit të veprës letrare; - të analizojë narracionin, gjuhën poetike dhe elementet e tjera të mjeshtërisë artistike; - të dallojë veçoritë e poemës epike; - të parashtrojë qëndrimin e tij ndaj veprës; - të njohë mitologjinë shqiptare të rikrijuar në poemën “Lahuta e Malcis”; - të reflektojë rreth lidhjeve të saj me mitologjinë popullore; - të analizojë origjinalitetin e Fishtës në rikrijimin e figurave mitologjike; - të eksplorojë vlerat artistike, kalimin nga realja te jorealja dhe funksionin e hiperbolës; - të parashtrojë qëndrimin e tij ndaj veprës; - të parashtrojë, nëpërmjet kahasimit, të përbashkëtat dhe dallimet midis veprës së Fishtës dhe veprave të tjera epike; - të realizojë ese përshkruese dhe argumentuese/ bindëse.

MODULI 4: Letërsi dhe kompozim

a) Vepër letarare (Ismail Kadare “Kronikë në gur”, “Darka e gabuar” dhe “E penguara”)

Tematika	Objektivat
<p>Qyteti-personazh dhe banorët e tij</p> <p>Njeriu dhe kërkesa e tij përiditet</p> <p>Gjuha dhe stili</p> <p>Interpretimi dhe gjykimi vetjak</p>	<p>Nxënësi është i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë se si shkrimtari e përdor gjuhën dhe strukturat e saj për të arritur një efekt të caktuar në vepër; - të gjejë mjetet e ndryshme retorike në veprat letarare dhe t'i përdorë ato në punët e tij me shkrim; - të dallojë karakteristikat bazë të një vepre letarare; - të përcaktojë specifikat e një personazhi, duke u bazuar në atë çfarë ai thotë në dialog, monolog etj.; - të demonstrojë të kuptuarit e ideve të një vepre apo fragmenti; - të interpretojë, nisur nga një perspektivë e caktuar, qëndrime dhe pozicione të hapura ose të nënkuptuara në vepër; - të komunikojë një përgjigje personale të ndjeshme dhe të arsyeshme në lidhje me veprën e lexuar.

b) Vepër letarare (Fatos Kongoli “Ne të tre”, “Lëkura e qenit”, “Jeta në një kuti shkrepësesh”, “Bolero në vilën e pleqve”)

Tematika	Objektivat
<p>Tema sociale në veprat e Fatos Kongolit</p> <p>Gjuha dhe stili</p>	<p>Nxënësi është i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të demonstrojë aplikimin e shprehive të të menduarit kritik rrëth stilit të autorit dhe veprave të tij; - të analizojë, nëpërmjet veprave letarare, se si ndërthuren

Interpretimi dhe gjykimi vetjak	<p>dhe kombinohen në mënyra të ndryshme tek individi, rrethana e faktorë të shumtë, si: mjedisi, vëtmia, sfida, tradita, injoranca, ambicia etj., si dhe të gjykojë ndikimin e tyre në zgjedhjet, vendimmarjet dhe veprimet e tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të komentojë përdorimin e mjeteve të stilistikës për krijimin e efekteve të caktuara në vepër; - të interpretojë, nisur nga një perspektivë e caktuar, qëndrime dhe pozicione të hapura ose të nënkuptuara në vepër; - të argumentojë rreth një çështjeje të caktuar.
---------------------------------	--

IV. NË KËTË LËNDË, NXËNËSIT DO TË TESTOHEN EDHE PËR NJOHURITË SHPREHËSE GJUHËSORE, SI MË POSHTË:

GJUHË SHQIPE	NJOHURITË GJUHËSORE
Leksikologji	Kuptimi i fjalëve Ngjyrimi emocional i fjalëve Dialektet dhe gjuha standarde
Morfosintaksë	Klasat e fjalëve (pjesët e ligjërëtës) Llojet e fjalive
Stilistikë gjuhësore	Mjetet morfollogjike të shprehësisë Figurat e sintaksës poetike: elipsa, lakonizmi, anafora, rendi i gjymtyrëve, shkallëzimi, enumeracioni, pyetja retorike Figura tingullore: aliteracioni Shprehësia tingullore: ritmi, rima, strofa Organizimi tërësor i një teksti: titulli, paragrafi, hyrja, shtjellimi, mbyllja
Të shkruarit	Ese përshkruese Ese bindëse/argumentuese
Drejtshkrim	Drejtshkrimi i shkronjës së madhe Drejtshkrimi i fjalëve në gjuhën shqipe Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit

V. LISTA E VEPRAVE LETRARE TË DETYRUESHME PËR T'U LEXUAR NGA NXËNËSIT

AUTORI	VEPRA LETRARE
Sabri Godo	Romani “Skënderbeu”

Shekspir	Tragjedia “Jul Çezari”
Gjergj Fishta	Poema “Lahuta e Malcis”
Ismail Kadare	Romani “Kronikë në gur”, Romani “Darka e gabuar” Romani “E penguara”
Fatos Kongoli	Romani “Ne të tre” Romani “Lëkura e qenit” Romani “Jeta në një kuti shkrepësesh” Romani “Bolero në vilën e pleqve”